

1
4704242
f

Në bazë të Nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, nenit 6, të Ligjit Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Gazetë Zyrtare Nr. 3/19 Prill 2018) dhe Nenit 6 paragrafi 4 dhe Nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 e Udhëzimit Administrativ MF-NR. 01/2019 Për Thelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik të datës 11.02.2019, Komiteti i Auditimit në Komunën e Suharekës i themeluar me vendim të Kryetarit të Komitës, nr/016/36045 me datën 27.06.2018 në mbledhjen e mbajtur me datën 16.01.2021 miratoi:

STATUTIN E KOMITETIT TE AUDITIMIT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i Statutit të Komitetit të Auditimit është të përcaktoj, përbërjen, anëtarësinë, pjesëmarrjen në takime, shpeshësinë e takimeve, autoritetin, detyrat, procedurat e raportimit dhe kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Statuti janë të detyrueshme për Komitetin e Auditimit i cili është organ i pavarur këshilldhënës dhe mbështetës për menaxhmentin e lartë në Komunë e Suharekës, që ka rol mbikëqyrës, bashkërendues i aktiviteteve të auditimit në subjektin e sektorit publik si dhe do të zbatoj me përpikëri tere dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ MF-NR. 01/2019 Për Thelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik.

Neni 3

Themelimi i Komitetit të Auditimit

Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjisllacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Neni 4

Roli i Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit mbështetë Kryetarin e komunës në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.

2. Komiteti I Auditimit mbështet Njësine e Auditimit të Brendshëm për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve të subjektit të audituar, operacionet e të cilëve auditohen dhe për të siguruar që rekomandimet e auditorit janë trajtuar si duhet nga Kryetari I Komunes.

Neni 5 Përbërja dhe Mandati I Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit emërohet nga Kryetari I Komunes dhe përbëhet nga tre (tre) ose pesë (5) anëtarë. Kryesuesi I Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë në pozitën udhëheqëse, dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të jashtëm, dhe pjesa tjetër nga stafi I brendshëm i Komunes.

2. Komiteti I Auditimit ka mandat(3) Vjeçar, me mundësinë e riemërimit, por jo më shumë se për dy (2) mandate të një pas njëshme.

3. Anëtarët e Komitetit duhet të kenë njohuri dhe përvojë së pakudy (2) Vjeçare në njëren nga këto fusha:

- 3.1 financa;
- 3.2 kontabilitet;
- 3.3 auditim të brendshëm;
- 3.4 auditim të jashtëm;
- 3.5 menaxhim të rrezikut;
- 3.6 legjislacion; dhe
- 3.7 teknologji informative.

4. Komiteti I Auditimit përgatit statutin I cili përfshinë përbërjen e Komitetit të Auditimit, pjesëmarrjen në takime, orarin, shpeshësinë e takimeve, autoritetin, detyrat dhe procedurat e raportimit. Statutin nshkruhet nga kryesuesi I Komitetit të Auditimit dhe aprovohet nga Kryetari I Komunes.

5. Një anëtar I një Komiteti të Auditimit nuk mund të emërohet dhe të jetë anëtar në të njëjtën kohë në ndonjë komitet tjetër të auditimit.

6. Pagesa e anëtarëve të Komitetit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit

1. Komiteti I Auditimit ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1 Këshillon Kryetarin e Komunes për çështjet që kanë të bëjnë me:
 - 1.1.1 Thelimin dhe zhvillimin e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të financave publike;
 - 1.1.2 vlerësimin e rrezikut;
 - 1.1.3 menaxhimin e rrezikut; dhe

1.2 Siguron marrëdhënie efektive dhe bashkëpunuese ndërmjet Kryetarit të Komunës, Zyrarit kryesor financiar, Njësise së Auditimit të Brendshëm dhe auditorit të jashtëm;

1.3 Miraton statutin e auditimit të brendshëm;

1.4 Shqyrton dhe miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, pa pasur kompetenca drejtuese për këto dokumente;

1.5 Mblidhëqyrë dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbylljen e planit të miratuar permes raporteve periodike nga udhëheqësi i Njësise së Auditimit të Brendshëm;

1.6 Siguron që mashtrimet e mundshme ose korrupsioni i dyshuar, të identifikuar nga raportet e auditimit të brendshëm ose të sjellë ndryshe në vëmendjen e Komitetit të Auditimit, të raportohen tek autoritetet kompetente;

1.7 Shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar sig duhet nga Kryetari i Komunës;

1.8 Shqyrton raportet e rregullta mbi statutin e zbatimit të planeve të veprimit të miratuara nga udhëheqësi që rezultojnë nga auditimet e më parshme të brendshme dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm;

1.9 Shqyrton pasqyrat financiare dhe opinionet e raporteve të auditimit të jashtëm; dhe

1.10 Shqyrton raportin vjetor për aktivitetet e Njësise së Auditimit të Brendshëm para se të dorëzohet në Njësine Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave.

Neni 7
Takimet e Komitetit të Auditimit

1. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) here në vit dhe flohen nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit. Takimi mbahet nëse shumica e anëtarëve të Komitetit të Auditimit marrin pjesë në takim. Në takime diskutohen gëshjet sig janë përcaktuar në Shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 Për Thelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik dhe gëshjet tjera. Në takime mbahen procesverbale të cilat ruhen së pakus shtatë (7) vjet në Njësine e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Suharekës

2. Kryetari i Komunës mund të kërkoj nga Komiteti i Auditimit të mbajë takime të tjera për të diskutuar gëshjet e caktuara, për të cilat ka nevojë për këshilla nga Komiteti i Auditimit.

3. Kur është e nevojshme, Komiteti i Auditimit mund të ftojë edhe zyrtarët dhe personat tjerë me kualifikim adekuat për të marrë pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit. Zyrtar kryesor financiar dhe udhëheqësi i Njësise së Auditimit të Brendshëm të Komunës së

dhe kur kërkohet nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

4. Udhëheqësi i Njësise së Auditimit të Brendshëm merr pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit, me përjashtim kur Komiteti i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performancën e Njësisesë Auditimit të Brendshëm të Komunes së Suharekës.
5. Njësia e Auditimit të Brendshëm e Komunës së Suharekës ofron shërbimet e sekretarises për Komitetin e Auditimit të Komunes së Suharekës.

Neni 8

Bashkëpunimi me palët kryesore

1. Komiteti i Auditimit bashkëpunon me Kryetarin e Komunës, zyrtarin kryesor financiar, auditorët e brendshëm dhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe rekomandimet e dhëna.
2. Komiteti i Auditimit mund të mbajë takime me akterët e përcaktuar në paragrafin 1 të brendshëm dhe jashtëm, raportin vjetor të aktiviteteve të auditimit të financiar e kontrollin.

3. Pas gdo takimi të realizuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, Komiteti i Auditimit raporton tek Kryetari i Komunës duke përmendhur aktivitetet e ndërrra dhe ofruar kështilla për veprimet e mëtejshme.

4. Komiteti i Auditimit ofron qasje të plotë dhe të papenguar te të gjitha të dhënat ose raportet e hartuara dhe të mirëmbajtura nga Komiteti i Auditimit, pas kërkesës së Zyrës Kombëtare të Auditimit ose autoriteteve të tjera publike të ngarkuara me funksione hetuese ose kontroli.

Neni 9

Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit

1. Komiteti i Auditimit përgatitë raport vjetor për Kryetarin e Komunës I cili përshinë informatat për:
 - 1.1 Përshtatshmërinë e mjedisit të kontrollit të brendshme, për të siguruar funksionim efektiv, efikas dhe të ligjshëm;
 - 1.2 Përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit rrezikut dhe menyrat e eliminimit të tyre;
 - 1.3 Pozitën financiare të Komunës, përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportimin e saj;
 - 1.4 Ndodhje dështim madhor të sistemit që vënë rrezik Komunën e Suharekës;
 - 1.5 Pavarësinë e auditorit dhe efektivitetin e Njësise së Auditimit të Brendshëm;
 - 1.6 Efikasitetin e Njësise së Auditimit të Brendshëm të komunës bëhet;
 - 1.6.1 Në shqyrtimin e menaxhimit të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm;
 - 1.6.2 Në dhënie e rekomandimeve praktike tek Kryetari i Komunës për përmirësimin e tyre;

rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe të Zyres Kombëtare të Auditimit; dhe

1.8 Përmbledhjen e punës së Komitetit të Auditimit.

2. Raporti vjetor i Komitetit të Auditimit i dorëzohet Kryetarit të Komunës dhe Zyres Kombëtare të Auditimit; më së largu deri më 31 mars.

3. Raporti vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni nuk do të përsëritet përmbajtjen e detajaur të raporteve të auditimit të brendshëm.

Neni 10 Dispozitat Përfundimtare

1. Procesverbalet e takimeve të Komitetit të Auditimit mbahen në pajtim me kërkesat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe detyrimsisht në fund të saj, duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

2. Komiteti i Auditimit mund të marr vendime me shumicën e votive që zotrojnë anëtarët e komitetit.

3. Për të gjitha gëshjet që nuk janë të përcaktuara në këtë Statut do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Gazeta Zyrtare Nr.3/19 Prill 2018) dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 11 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti i Komitetit të Auditimit të Komunës së Suharekës i mujat Dhjetor të vitit 2011.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i KA dhe Kryetarit të Komunës e Suharekës, nga:

Z. Liman Morina
Kryesuesi Komitetit të Auditimit



Z. Bali MUHARREMAJ
Kryetari i Komunës